



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit
Zyra e Kryetarit



01-Nr ~~010-71395~~ dt. ~~17.12~~ 2019

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të propozimit 08-Nr.030-70789 dt. 13.12.2019, paraqitur nga Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (GZ Nr.28/2008), nenin 72 të Statutit të Komunës së Glllogocit 01-Nr.110-6904 dt. 24.09.2008, mori:

V E N D I M

- I. Lejohet fillimi i procedurave për hapjen e konsultimit publik për Propozimin profesional për shpalljen e lokalitetit Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh, pjesë e fshatit Sankoc, Komuna e Glllogocit- "Zonë e Mbrojtur në Kategorinë e Monumentit të Natyrës".
- II. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e Vendimit është kompetencë e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.



Kryetari i Komunës

[Signature]
Ramiz Lladrovci

Vendimi i'u dërgohet:

- Zyres së Kryetarit;
- Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Arkivit;



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Glllogocit



Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

08-Nr -070-71395 dt. 18.12.2019

Në bazë të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Glllogocit 01-Nr.070-71395 të datës 17.12.2019, për lejin e hapjes së konsultimit publik për Propozimin Profesional për shpalljen e lokalitetit të Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës për arealin e kësaj bime (Sankoc) në pjesën e Komunës së Glllogocit të punuar nga grupi punues, paraqesim këtë:

NJOFTIM
SHPALLJE PUBLIKE

Komuna e Glllogocit fton dhe njofton qytetarët për të shprehur mendimet për Propozimin Profesional për shpalljen e lokalitetit të Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës.

Afati për shprehje të mendimeve, sugjerimeve, komenteve e vërejtjeve për këtë propozim dokument do të jetë nga data 18.12.2019 deri me 17.01.2020.

Vërejtjet, komentet, këshillat, sugjerimet mund t'i drejtoni në email adresat: komuna.drenas@rks-gov.net dhe qenan.maxhuni@rks-gov.net ose mund të i dorëzoni në kopje fizike në objektin e komunës, në zyret e Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Propozimin profesional për shpalljen e lokalitetit të Boshtres (Forsythia europaea) në Golesh si Monument i mbrojtur i natyrës në pjesën e Komunës së Glllogocit mund të meret edhe në web faqën: <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/>.

Drejtori për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit

